



Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “BE-IS” shpk dhe “Agi Kons” shpk.

Adresa: “Lagjja Nr.1, Pallati Metalurgu, Hyrja Nr. 1”, Tirane dhe “Kodra e Diellit II, Godine e Kombinuar 4, Kat+ 1 kat nentoke, Selite, Farke, Tirane

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rikualifikim urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rrugët “Don Bosko” – “Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikualifikim urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rrugët “Don Bosko” – “Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”.

Fondi limit: 343,769,360 (treqind e dyzetë e tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve me vendimin nr. 10, datë 10.03.2016 ”Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1, datë 04.02.2016 të Komitetit për zhvillimin e rajoneve dhe për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit ’infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, Shtylla I, Thirrja I për vitin 2016”.

Kohëzgjatja e kontratës: 18 (tetëmbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 01.08.2016, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 27 datë 11.07.2016.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimimi i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “BE-IS” shpk & “AgiKons” shpk

NUIS K71412003A dhe NUIS K21622001M

Vlera e ofertës = **276,469,673** (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

2. Bashkimioperatorëveekonomikë “N.T.P Eurokos”-DeganëShqipëri&“Arifaj” shpk& “Denis-05” shpk.

NUIS K91727010ANUISJ76418907Kdhe NUISK51518029B

Vlera e ofertës = **310,071,267.5** (treqind e dhjetë milion e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë pesë) lekë pa TVSH.

Nuk është s’kualifikuar asnjë operator ekonomik:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BashkimineOperatorëveEkonomikë “BE-IS” shpkdhe “AgiKons” shpk**, me adresë:**Lagjja Nr.1, Pallati Metalurgu, Hyrja Nr. 1” , Tirane dhe “Kodra e Diellit II, Godine e Kombinuar 4, Kat+ 1 kat nentoke, Selite, Farke, Tirane**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **276,469,673** (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:04.08.2016

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.